

Fjala e Rektorit Prof. Dr. Bajram Kosumi, 1 Tetor 2021

1.

Sot është dita kur duhet te bashkëndejmë më shumë se kurrë me universitetin, me UKZ-në, me studentët, me stafin akademik, me administratën dhe me hisedarët e dashamirët e tjerë. Sot është dita, sepse:

- Sot është 1 tetori e nuk fillon viti akademik. Sapo nënshkrova vendimin e Senatit për fillimin e vitit akademik më 15 tetor, për shkak të pezullimit të procesit akademik deri më 27 shtator për shkak të masave anti Covid, sipas Vendimit të Qeverisë nr. 0137 të datës 24.09.2021;
- Covidi po vazhdon ta pengojë procesin e studimeve, sa do ne po provojmë të përshtatemi e të gjejmë zgjidhje dytësore;
- Për shkak të gjendjes me covid, për shkak të papunësisë së madhe dhe shumë faktorëve të tjerë kulturorë e demografikë, studenti është i demoralizuar nga mësimi e fakulteti;
- Për shkak të lëvizshmërisë së popullatës së re në Perëndim, për herë të parë sivjet ka një rënie të dukshme të konkurrencës në programet studimore, jo vetëm të UKZ por në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. Dhe jo vetëm në disa programe, por në tërësinë e tyre ka rënie.

2.

Sot është një gjendje jo e zakonshme për arsimin e lartë në Kosovë.

Më shumë se kurrë universiteti është në duart e stafit akademik:

- sa do të tregohen ata inventivë që të përshtaten në kushtet e reja në të cilat po kalon universiteti (mësimi në distancë; modernizimi i universitetit; proceset globaliste etj.)?
- sa ata janë të gatshëm të aplikojnë metodologji të reja mësimdhënieje dhe hulumtimi për ta mbajtur zgjuar interesimin e studentëve në proces?
- Sa ata janë të gatshëm të gjejnë forma të reja të ndërlidhjes akademi-treg i punës.

3.

Stafi akademik vetë ka hyrë në një fazë, në të cilën duhet të përcaktohet qarte në rrugën e profesorit, pra se është vetëm profesor dhe hulumtues.

Rregullat e reja për akreditim, të miratuara në shtator të këtij viti, kanë hapur një rrugë të re për stafin akademik dhe e përkufizojnë qartë rrugën e tij, prandaj sa më parë të futet në këtë rrugë është vendimtare për ta dhe studentët. Ata që nuk mund të përshtaten në këtë rrugë dhe ato programe studimore që nuk mund të përshtaten, nuk e kanë të ardhmen të sigurt.

Ndërlidhja me universitetet e tjera është vendimtare në rrugën e secilit universitet: nuk mund të mbijetojë një universitet i izoluar e klasik në shoqërinë e internetit dhe te globalizmit.

- vetëm duke bere studime ne gjuhe angleze e te tjera mund te kyçemi ne këtë rrjedhë;
- vetëm duke organizuar shkolla verore a dimërore;

- vetëm duke qenë pjesë e procesit akademik global, si në hulumtime, ashtu edhe në konferenca shkencore, në ligjërata, në mobilitet të stafit akademik e të studentëve, në qarkullimin e ideve dh dijeve, vetëm në këto rrethana dhe në asnjë lloj tjetër, universiteti ynë mund të mbijetojë.

4.

Dhe në fund disa çështje teknike:

- Stafi akademik ta kalojë tërë ditën në UKZ, pranë studentit;
- Të mbushen zbrazëtitë e krijuara në mësim e hulumtime gjatë mësimit onlajn;
- Të krijohen kushte mësimi e hulumtimi që u përshtaten studentëve;
- Stafi akademik të bashkëpunojë me studentët edhe pas orëve të ligjëratave e të ushtrimeve: le të krijojnë një mjedis akademik ku studentët mësojnë edhe gjatë bisedave të lira apo gjatë pauzës së kafes.